




Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Autoriteti i Konkurrencës
Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority



Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës të Republikës së Kosovës, në mbështetje të Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës neni 26 paragrafi (1) nën paragrafi (1.1), në mbledhjen e mbajtur me datë 21.12.2023, miraton:

RREGULLORE NR. 05/2023 PËR KUSHTET DHE RREGULLAT E PËRDORIMIT TË AUTOMJETEVE ZYRTARE NË AUTORITETIN E KONKURENCËS

Neni 1

Me këtë Rregullore përcaktohen kushtet dhe mënyra e përdorimit të automjeteve zyrtare të Autoritetit të Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Autoriteti) të drejtat dhe përgjegjësitë e të punësuarve në Autoritet, lidhur me përdorimin e automjeteve.

Neni 2

Në kuptim të kësaj Rregulloreje, i punësuar do të thotë personi i cili është i punësuar për një kohë të pacaktuar ose të caktuar dhe personi i emëruar në Komisionin e Autoritetit.

Neni 3

1. Në kuptim të kësaj Rregulloreje, automjet zyrtar do të thotë: automjeti që është në pronësi të Autoritetit ose në shfrytëzim me qera.
2. Nëse ndonjëri nga të punësuarit nuk i respekton dispozitat e kësaj Rregulloreje, Autoriteti mbanë të drejtën e inicimit të procedurës disiplinore.

Neni 4

1. Automjetet përdoren për kryerjen e detyrave të punës në gjithë territorin e Republikës së Kosovës.
2. Automjetet mund të përdoren edhe për udhëtime zyrtare jashtë vendit.
3. Automjetet përdoren në bazë të autorizimit të Kryetarit ose personit të autorizuar nga Kryetari, duke ju përmbajtur dispozitave të kësaj Rregulloreje dhe Ligjeve në fuqi.
4. Automjetet përdoren gjatë orarit të punës dhe pas orarit të punës sipas nevojës.
5. Kryetari, Nënkryetari dhe anëtarët e Komisionit të Autoritetit, kanë të drejtë në përdorim të automjetit 24 orë / 7 ditë në javë.
6. Drejtori i përgjithshëm dhe Drejtorët e Departamenteve, me lejen e Kryetarit ose personit të autorizuar nga Kryetari, mund ta përdorin automjetin edhe jashtë orarit të punës.
7. Para përdorimit të automjetit, paraprakisht duhet të kontrollohet automjeti dhe të sigurohet se janë plotësuar kushtet për të dalë automjeti në komunikacion.
8. I punësuar i cili drejton automjetin përgjigjet për mos respektimin e rregullave të komunikacionit.

Neni 5

1. I punësuar i cili drejton automjetin është i obliguar që të plotësojë fletëudhëtimin me këto të dhëna:

- Data,
- Emri dhe mbiemri i drejtuesit të automjetit,
- Numri i ID-së,
- Relacioni i udhëtimit,
- Qëllimi i udhëtimit,
- Koha e nisjes dhe kthimit,
- Kilometrat e fillimit dhe të mbarimit të udhëtimit,
- Kilometrat e kaluara dhe
- Nënshkrimi i drejtuesit të automjetit.

2. I punësuar i cili ka drejtuar automjetin është i obliguar që pas kryerjes së punës zyrtare, të parkoj automjetin në parking zyrtar dhe Drejtorit të Departamentit Juridik dhe Administratës - DJA (në tekstin e mëtejshëm: Drejtorit të DJA-së) t’ia dorëzoj çelësat dhe fletëudhëtimin e plotësuar, si dhe ta njoftoj për gjendjen e automjetit të përdorur.

Neni 6

1. Kryetari ose personi i autorizuar nga Kryetari, lejon shfrytëzimin e automjetit bazuar në kërkesën e parashtruar nga i punësuar.

2. Të gjithë të punësuarit në kuadër të detyrave të punës, janë të obliguar që me kohë të bëjnë planifikimin e shfrytëzimit të automjeteve.

Neni 7

1. Drejtori i DJA-së kujdeset për shfrytëzimin racional dhe ekonomik të automjeteve dhe ndërmerri masat e nevojshme përmes angazhimit të vozitësit, për servisimet, kontrollimet teknike dhe regjistrimet e automjeteve.

2. Të gjithë përdoruesit e automjeteve janë të obliguar që Drejtorit të DJA-së t’ia paraqesin faturën për derivatet e shpenzuara me qëllim të mbajtjes së evidencës.

Neni 8

1. Nëse të gjitha automjetet janë në përdorim apo për ndonjë arsye tjetër nuk mundë të përdorën, Kryetari mundë të lejoj shfrytëzimin e auto taksive për kryerjen e punëve zyrtare kur paraqiten nevoja urgjente.

2. Përdoruesi i auto taksisë është i obliguar që ta marrë kuponin fiskal për shpenzimet e bëra, të cilin kupon do ta vërtetoj Drejtori i DJA-së.

Neni 9

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Autoritetit të Konkurrencës.

Neime Binaku-Isufi

Kryetare e Autoritetit të Konkurrencës të Republikës së Kosovës

